



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHKODËR**

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Shkodër, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2019

Lënda: “Informacion mbi shërbimin me shezllone në plazhin publik Velipojë”

\_\_\_\_\_  
Email: \_\_\_\_\_

Në përgjigje të shkresës suaj me subjekt, “Informacion mbi shërbimin me shezlongje në plazhin publik Velipojë”, të datës 18/06/2019, me nr prot. 10525, ju bëjmë me dije sa vijon:

Bashkia Shkodër ushtron funksionet dhe kompetencat e saj për sa i përket menaxhimit të vijës së rërës në plazhin e Velipojës duke u mbështetur në ligjin nr. 139 datë 17. 12.2015 "Per vetëqeverisjen vendore", Ligjin Nr. 93/2015 “PËR TURIZMIN”, VKM Nr. 358, datë 1.6.2012. “PËR SIGURINË NË DET, PLAZHE DHE NË UJËRAT E BRENDSHME NË THELLËSI TË TERRITORIT”, VKM nr. 171 datë 27.03.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”.

Bashkia Shkodër së pari ka përgatitur hartat e stacioneve të plazhit dhe i ka publikuar ato në faqen web të Bashkisë

([http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Hapesirat\\_Publike\\_Stacionet\\_e\\_Plazhit\\_256\\_1.php](http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Hapesirat_Publike_Stacionet_e_Plazhit_256_1.php)) .

Me datën 4 Prill 2019 ka bërë thirrjen për bizneset për të aplikuar për shfrytëzim të hapësirës publike në plazhin e Velipojës për ngritjen e stacioneve të plazhit. [http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/njoftim\\_stacione\\_plazhi\\_2019\\_2289.pdf](http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/njoftim_stacione_plazhi_2019_2289.pdf)

Subjektet e interesuara kanë aplikuar por me mangësi të mëdha në dokumentacion për shkaqe objektive dhe subjektive për mosnjohje të kerkesave të VKM së re 171 dhe janë ftuar të bëjnë plotësimin me dokumentacion të aplikimit të tyre.

Aktualisht janë shqyrtuar të gjitha aplikimet dhe po procedohet me lajmërimin individual të subjekteve të cilat do të duhet të vërtetojnë plotësimin e kushteve të stacionit të plazhit konform VKM 171 dhe gjithashtu edhe të procedojnë me shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata me Bashkinë Shkodër.

Për mbarëvajtjen e këtyre stacioneve, subjektet punësojnë punonjës me kontratë të cilët regjistrohen pranë zyrës së sigurimeve shoqërore, gjithashtu subjektet janë të detyruara që para lidhjes së kontratës me Bashkinë Shkodër duhet të paraqesin edhe një kontratë pune me roje plazhi të çertifikuar nga institucionet përkatëse.

Monitorimi I këtyre stacioneve të plazhit kryhet nga një seri institucioneve sipas kompetencave respektive të secilit institucion. Se pari monitorohen nga drejtoritë e Bashkisë Shkodër, Drejtoria e të Ardhurave, Drejtoria e Policisë Bashkiake dhe Administratori i Velipojës.

Agjensia Kombëtare e Bregdetit monitoron stacionet e plazhit dhe perpiln raporte individuale për secilin subjekt në bazë të të cilit rinovohet ose jo kontrata për vitin pasardhës.

Drejtoria Rajonale e Tatimeve

Inspektoriati i turizmit

Grupi ndërinstytucional i ngritur nga Institucioni i Prefektit bën vëzhgime të përjavshme për situatën në plazh dhe harton raporte monitorimi.

Ka pasur raste shkeljeje dhe në varesi të llojit dhe masës së shkeljes janë marre edhe masat përkatëse nga policia bashkiake, drejtoria e të ardhurave në bashkëpunim edhe me policinë e shtetit.

**KRYETAR**  
**Voltana Ademi**

**Me vendim delegimi nr. 109, dt 29/06/2019**  
**ZV/KRYETAR**  
**Emilia Koliqi**